



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2018

V E N D I M

Nr. 79, Datë 19/03/2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mbështetur në nenin 32, pika 1, germa c), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, bazuar në Urdhrin nr. 174, datë 01.11.2016¹, filloi procedurën e shqyrtimit të çështjes “ex-officio” të ndërprerjes së furnizimit me ujë të pijshëm për banorët e fshatit Gurëz, Njësia Administrative Fushe Kuqe, Bashkia Kurbin”.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Mbështetur në informacionin e përcjellë në adresën e Komisionerit nga qytetari D. D², bëhet me dije se ish Komuna Fushë-Kuqe, tashmë Njësia Administrative Fushë-Kuqe, Bashkia Kurbin, ka vendosur ndërprerjen e furnizimit me ujë të pijshëm për banorët e fshatit Gurëz, ndonëse nuk posedon asnjë vendim me shkrim për këtë ndërprerje. Sipas ish Kryetarit të kësaj Komune, Z. Gj. M, “*ndërprerja e furnizimit me ujë ka ardhur si rezultat i refuzimit të pagimit të taksës mujore prej 500 lekësh, nga banorët e saj. Për këtë arsye, Komuna vetë nuk mund ta përballojë pagesën e energjisë elektrike që harxhohet për furnizimin me ujë dhe ofrimin e këtij shërbimi falas. Shumica e*

¹ Urdhër “Për fillimin e procedurave për ndjekjen “ex-officio” të çështjes së ndërprerjes së furnizimit me ujë të pijshëm banorëve të fshatit Gurëz, Njësia Administrative Fushe Kuqe, Bashkia Kurbin”.

² Informacioni ka ardhur në adresën elektronike të Komisionerit, info@kmd.al, nga qytetari D. D, i cili mbështetur në të dhënat e kartës së identitetit, është nënshtruar shqiptar, i lindur në Gurëz, Krujë. Aktualisht D. D jeton në Mbretërinë e Bashkuar .

shtëpive/banorëve kanë hapur burime private dhe kjo është arsyeja që nuk bien dakord të paguajnë”.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Komisioneri, mbështetur në tagrat që i ka dhënë ligji 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, konkretisht neni 32, pika 1, gërma c) “Komisioneri ka kompetencë të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji” dhe neni 32, pika 2 “Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”, vendosi ndjekjen e çështjes kryesisht, bazuar në Urdhërin nr. 174, datë 01.11.2016 “Për fillimin e procedurave për ndjekjen “ex officio” të çështjes së ndërprerjes së furnizimit me ujë të pijshëm banorëve të fshatit Gurëz, Njësia Administrative Fushe-Kuqe, Bashkia Kurbin”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri ndërmori hapat e mëposhtëm:

1. Me shkresë nr. 989/1 prot, datë 02.11.2016, iu dërgua kërkesë për informacion dy subjekteve: Bashkisë Kurbin dhe Njesisë Administrative Fushë-Kuqe, Kurbin. Sipas kësaj shkrese subjekteve iu kërkuan sqarime lidhur me:

- Bazën ligjore të zbatuar për marrjen e vendimit për ndërprerjen e furnizimi me ujë të pijshëm për banorët e fshatit Gurëz, Kurbin.
- Sqarime për hapjen e burimeve private. Sa janë të mështetura ligjërisht dhe çfarë detyrimesh parashikon ligji.

Përsa më sipër, Komisioneri thekson se asnjëri prej subjekteve nuk dërgoi informacion në lidhje me çështjen.

2. Në vijim të procedurave të hetimit administrative, përmes Urdhrit nr. 201, datë 09.12.2016, me shkresë nr. 1110/1 prot, datë 09.12.2016, Komisioneri njofton Bashkinë Kurbin, lidhur me inspektimin që do të kryejë pranë këtij institucioni, me qëllim hetimin dhe verifikimin e çështjes së ndërprerjes së furnizimit me ujë të pijshëm të banorëve të fshatit Gurëz, Njësia Administrative Fushë-Kuqe, Kurbin.

- Mbështetur në urdhrin e mësipërm, inspektimi u zhvillua në datë 20.12.2016. Inspektorët e Komisionerit u takuan me N/Kryetarin e Bashkisë së Kurbin z. G. D. dhe Drejtorin e Shërbimeve Publike, z. P. M. Objekti i inspektimit ishte:

- Informimi mbi faktin e ndërprerjes me ujë të pijshëm të banorëve të fshatit Gurëz, Kurbin.
- Bazën ligjore dhe vendimin mbi të cilin është bërë ndërprerja me ujë.
- Sqarime për hapjen e burimeve private. A janë të lejuara me ligj hapja e këtyre burimeve?
- Nëse po, cilat janë detyrimet e banorëve, në bazë të ligjit?
- A është aplikuar masa e ndërprerjes së furnizimit me ujë nga ana e Bashkisë edhe në ndonjë zonë tjetër, në varësi të kësaj Bashkie?

- Çfarë masash janë marrë dhe si është zgjidhur çështja?
- Administrim i akteve që kanë lidhje me çështjen.

- Përsa më sipër, N/Kryetari i Bashkisë, z. G. D. ka sqaruar se: *“pranë Bashkisë Kurbin nuk është depozituar asnjë ankesë apo shqetësim i ardhur nga banorët e Fshatit Gurëz. Sipas tij, ndërprejra e furnizimit me ujë nuk është bërë me qëllim që të lërë banorët pa ujë, por sepse sistemi i ujit i ndërtuar në këtë zonë nuk ishte i përdorshëm prej tyre”*.

- I pyetur në lidhje me hapjen dhe shfrytëzimin e burimeve private, z. G.D. sqaroi se *“zona e Fushë-Kuqes është një zonë ujëmbajtëse që furnizon Kurbinin, Durrësin e deri në Rogozhinë. Hapja e puseve nuk është bërë tani. Ajo është një praktikë e njohur më parë, gjatë kohës kur zona nuk ka patur një system furnizimi elektrik, me pompa, pasi ishte mënyra e vetme e furnizimit me ujë”*.

- Lidhur me pikat e tjera objekt i inspektimit, **nga ana e Bashkisë Kurbin u kërkua kohë dhe u ra dakord mes palëve që deri më datën 10.01.2017, do të depozitonin aktet dhe dokumentacionin me provat për çështjen.**

- Procesverbali i inspektimit administrativ, pasi u lexua nga palët e pranishme dhe pasi u konsiderua se çdo fakt është parashtruar dhe pasqyruar drejt në të, u nënshkrua nga të pranishmit në cdo fletë të tij. Procesverbali u mbajt në 2 (dy) kopje, njëra prej të cilave iu dorëzua subjektit të kontrolluar.

Për sa më sipër, **Bashkia Kurbin nuk dërgoi asnjë përgjigje dhe nuk depozitoi asnjë provë në adresë të Komisionerit, as në datën e caktuar dhe as në ditët në vazhdim.**

Për sa më sipër, pas kryerjes së të gjithë hapave proceduriale për shqyrtimin e çështjes, Komisioneri vlerësoi se:

Bashkia Kurbin nuk ka ofruar bashkëpunim, duke mos dhënë informacionin e kërkuar nga Komisioneri, mbi bazën e të cilit do të shqyrtohej çështja e ndërprerjes së furnizimit me ujë të pijshëm për banorët e Fshatit Gurëz. Në këto kushte, nmbështetur në parashikimet e nenit 33, pika 13, gërma c): *“Çdo person që shkel dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë si më poshtë:*

a) personi fizik, nga 10 000 deri në 60 000 lekë;

b) personi juridik nga 60 000 deri në 600 000 lekë;

c) personi fizik brenda personit juridik, i cili është përgjegjës për shkelje, nga 30 000 deri në 80 000 lekë;

ç) personi, i cili ushtron funksion publik dhe është përgjegjës për shkelje në bazë të këtij ligji, nga 30 000 deri në 80 000 lekë”, me Vendim nr. 6, datë 06.02.2017, Komisioneri vendosi të zbatojë masën e gjobës, në vlerën 100 mijë lekë, ndaj saj, duke i dhënë kohë që brenda afateve ligjore parashikuar në nenin 33, pika 11³, të informonte Komisionerin lidhur me masat për zbatimin e tij, i cili do të sillte edhe shfuqizimin e masës së gjobës.

³ Nenit 33, pika 11: “Nëse Komisioneri urdhëron rregullime ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para Komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon Komisionerin ose

Përmes shkresës nr. 692/1 Prot, datë 13.02.2017, në shkelje të afateve ligjore, Bashkia Kurbin ka kërkuar nga Komisioneri shfuqizimin e Vendimit nr. 6, datë 06.02.2017, pa iu përgjigjur kërkesës për informacion.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar me ligjin 44/2015, përkatësisht neni 95⁴ dhe në Ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përkatësisht neni 32, pika 1, gërma b), e pika 2, si dhe nenin 33, pika 10,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Pushimin e shqyrtimit të çështjes “ex-officio” të ndërprerjes së furnizimit me ujë të pijshëm për banorët e fshatit Gurëz, Njësia Administrative Fushe Kuqe, Bashkia Kurbin, për shkak se nuk disponon prova të mjaftueshme për të vërtetuar, nëse janë ekspozuar kundrejt trajtimit të padrejtë e diskriminues nga ana e kësaj Bashkie.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve të parashikuara me ligj.

KOMISIONERI

IRMA BARAKU

Fusha – te mira e sherbime
Shkak – gjendja ekonomike

nuk e zbaton vendimin, Komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni”.

⁴ Neni 95 i K. Pr. Adm: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”.